



EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS  
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME

Legal summary prepared for HUDOC by © Consulate General of the Republic of Kosovo in Strasbourg

Përmbledhje juridike e përgatitur për HUDOC nga © Konsullata e Përgjithshme e Republikës së Kosovës në Strasburg

February / Shkurt 2026

---

## ***Danileț k. Rumanisë [Dhoma e Madhe] - 16915/21***

Aktgjykim i 15.12.2025

### **Neni 10 Liria e shprehjes**

Ndëshkimi disiplinor i një gjyqtari për shkak të dy postimeve në Facebook: *shkelje*.

### **Faktet**

Në kohën e ngjarjeve, janar 2019, ankuesi ishte gjyqtar në gjykatën rajonale të Kluzhit, Rumani. Ai ishte i njohur në publik për pjesëmarrje aktive në debatet për demokracinë, sundimin e ligjit dhe sistemin gjyqësor.

Në periudhën në fjalë, lindi një mosmarrëveshje e theksuar politike dhe institucionale ndërmjet, ndër të tjerë, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Presidencës lidhur me zgjatjen e mandatit të Komandantit të Forcave të Armatosura.

Në këtë kontekst, më 9 janar, gjyqtari (ankuesi) postoi në Facebook mesazhin e parë me këtë përmbajtje:

Mund të keni vënë re vargun e përpjekjeve për të sulmuar, përçarë dhe diskredituar institucione të tilla si Drejtoria e Përgjithshme e Informacionit dhe Mbrojtjes së Brendshme, Shërbimi Rumun i Inteligjencës, Policia, Drejtoria Kombëtare Antikorrupsion, Xhandarmëria, Prokuroria pranë Gjykatës së Lartë,

Gjykata e Lartë dhe Ushtria. [Sulmet në fjalë] nuk ndodhën thjesht rastësisht pas 'abuzimeve të kryera nga zyrtarët'. A e kuptojnë njerëzit se çfarë do të thoshte dobësimi i këtyre institucioneve ose, edhe më keq, vënia e tyre, e policisë, gjykatave dhe ushtrisë nën kontroll politik? Dhe, duke folur për ushtrinë, a keni menduar ndonjëherë seriozisht për nenin 118, paragrafi 1 të Kushtetutës, i cili parashikon se 'ushtria i shërben vetëm vullnetit të popullit për të ruajtur ... demokracinë kushtetuese'? Çfarë do të ndodhte nëse një ditë ushtria do të shihej në rrugë duke mbrojtur ... demokracinë, sepse mbështetja duket se po zbehet këto ditë? A do të habiteshit nëse mësoni se kjo zgjidhje do të ishte... kushtetuese?! Nuk po shohim pyllin se jemi të fokusuar tek një pemë (...).

Në postimin e dytë, më 10 janar, gjyqtari në fjalë (ankuesi) shpërndau një artikull me titull "*Një prokuror jep alarmin. Të jetosh në Rumani sot përbën një rrezik të madh. Vija e kuqe është kaluar kur bëhet fjalë për sistemin e drejtësisë*". Artikulli përmbante intervistën e një prokurori i cili shprehte pikëpamjet e tij për vështirësitë që kishin prokurorët në punën e tyre. Ankuesi e shpërndau artikullin duke komentuar:

Ja një prokuror me gjak në vena që thotë çfarë mendon për lirimin e të burgosurve të rrezikshëm, idetë e këqija të udhëheqësve tanë për reformën në drejtësi dhe 'linqimin' e gjyqtarëve e prokurorëve!

Më 7 maj 2019 organi vendimmarrës disiplinor i shqiptoi gjyatarit (ankuesit) masën ulje page me 5% për dy muaj duke gjykuar se përmes postimeve në Facebook ai kishte kryer shkeljen disiplinore të dëmtimit të imazhit dhe nderit të sistemit gjyqësor. Më 18 maj 2020, Gjykata e Lartë e rrëzoi ankesën e tij. Këto autoritete arritën në përfundimin se postimet e gjyqtarit (ankuesit): (i) vinin në dyshim besueshmërinë e institucioneve; (ii) nuk ishin në pajtim me detyrimin e gjyqtarëve për të qenë diskretë, të vetëpërmbytur, të paanshëm, të pavarur; dhe madje (iii) aludonin për mundësinë e daljes së ushtrisë në rrugë si zgjidhje për të ruajtur demokracinë.

## **Arsyetimi juridik i GjEDNj**

### Përmbajtja e postimeve

Sa i përket postimit të parë, fakti që ai lidhej një mosmarrëveshje institucionale dhe politike mbi mandatin e Komandantit të Forcave të Armatosura nuk është i mjaftueshëm për t'i ndaluar ankuesit të shprehet në lidhje me të. Gjyqtari (ankuesi) shprehu një opinion individual mbi ndarjen e pushteteve, opinion që nuk mund të cilësohet si objektivisht i saktë apo i pasaktë. Autoritetet kombëtare nuk shpjeguan se në ç'mënyrë opinionet e gjyqtarit (ankuesit) mund të kishin dëmtuar funksionimin e duhur të sistemit të drejtësisë, dinjitetin dhe nderin e gjyqësorit

ose besimin e publikut në të. Megjithëse postimi përmbante pak ambiguitet, çfarë idealisht duhet shmangur, kjo nuk mjafton për të konkluduar që gjyqtari (ankuesi) u bëri thirrje lexuesve të dalin në rrugë ose të përdorin dhunë, ose që postimi i tij pati këtë efekt.

Postimi i dytë lidhej me vështirësitë që hasin magjistratët (gjyqtarët/prokurorët) rumunë, pra kishte të bënte me një temë me interes publik (funksionimi i sistemit të drejtësisë) dhe rrjedhimisht gëzon një shkallë të lartë mbrojtjeje sipas Nenit 10. Autoritetet kombëtare e kritikuan gjyqtarin (ankuesin) për përdorimin e shprehjes "gjak në vena" por pa shpjeguar mjaftueshëm se përse kjo shprehje tejkalonte ndjeshëm kufijtë e komunikimit të përshtatshëm të magjistratëve.

#### Konteksti dhe cilësia në të cilën ankuesi u shpreh

Postimet e gjyqtarit (ankuesit) gëzojnë një mbrojtje të posaçme pasi ato ishin opinione personale që synonin rritjen e ndërgjegjësimit publik në lidhje me një debat me interes shoqëror të lartë. Postimet e gjyqtarit (ankuesit) nuk diskutonin çështje gjyqësore në gjykim (procesi gjyqësor për mandatin e Komandantit nisi pas postimeve dhe u zhvillua në një gjykatë të ndryshme nga ajo e ankuesit).

Pasojat negative të postimeve: Autoritetet vendase nuk dhanë shpjegime të mjaftueshme për këtë aspekt.

Rreptësia e ndëshkimit: sanksioni disiplinor nuk ishte tejet i rëndë megjithatë ishte i atillë që mund të dekurajonte gjyqtarin (ankuesin) dhe magjistratët e tjerë të shpreheshin në të ardhmen.

Garancitë procedurale: Gjyqtari (ankuesi) ushtroi të drejtat e tij procedurale për të kundërshtuar masën disiplinore; megjithatë, autoritetet që gjykuan çështjen nuk u thelluan në shqyrtimin e përmbajtjes së postimeve, kontekstit dhe pasojave të tyre si dhe efektin e mundshëm dekurajues të masës disiplinore.

**Përfundimi:** shkelje e lirisë së shprehjes së gjyqtarit sipas nenit 10 KEDNJ (dhjetë vota pro, shtatë kundër).

**Dëmshpërblim (Neni 41):** nuk u kërkua.

**Shënim:** Aktgjykimi i plotë është më i detajuar; kjo përmbledhje përmban vetëm elementet thelbësore të arsyetimit dhe përfundimet kyçe të GjEDNJ.